REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT KORÇË**

# VENDIM

**NR 08 ,Dt. 15.03.2024**

## PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KALIMIN NË PRONËSI TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË TË PRONAVE, IDENTIFIKUAR SI PASURITË ME NR.2/12 VOL.27 FAQE 167, NR.2/539-ND,VOL.27,FAQE 168, TRUALLI NËN NDËRTESËN NR.2/708-N1, PJESË E PASURISË NR.2/10, VOL.33, FAQE 19 TË CILAT JANË NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 77 gërma (e), me propozim të Kryesisë të Këshillit të Qarkut Korçë.

**V E N D O S I**

1. Të miratojë dhënien e dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë, të pasurive të identifikuara me Nr.2/12 vol.27 faqe 167 me sipërfaqe 349,6 m² , Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168 me sipërfaqe 442 m², trualli nën ndërtesën nr.2/708-N1, identifikuar me pasurinë nr.2/10, vol.33, faqe 19, me sipprfaqe 652,88 m².
2. Të vijohet korrespondenca me institucionet e tjera përgjegjëse, procedura për kalimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë të pasurive objekt vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Specialisti i nivelit të lartë për shërbimet, Burimet Njerëzore dhe Emergjencat civile dhe Kabineti i Kryetarit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT**

**ERJON NEXHIPI**

**Koncept. : R. Latollari**
**Kësh. Juridik : Gj.Kristo**
**Sekretar i K.Qarkut: B.Muço**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - KËSHILLI I QARKUT KORÇË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT KORÇË**

# RELACION

**"PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KALIMIN NË PRONËSI TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË TË PRONAVE , IDENTIFIKUAR SI PASURITË ME NR.2/12 VOL.27 FAQE 167;NR.2/539-ND,VOL.27,FAQE 168;, TRUALLI NËN NDËRTESËN NR.2/708-N1, PJESË E PASURISË NR.2/10, VOL.33, FAQE 19 TË CILAT JANË NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË"**

Aktualisht Këshilli i Qarkut Korçë zotëron pasurinë Nr. 2/708-N2, Vol. 43 Fq. 82 në ZK. 8564, me sipërfaqe 552.28 m², dhe pasurinë nr. 2/708-N1, Vol. 43 Fq. 81 në ZK 8564, me sipërfaqe 652.88 m² të regjistruar në zbatim të VKM-së Nr. 601 datë 31.08.2016 "Për kalimin në pronësi të ndërtesës e të mjediseve administrative, nga Këshilli i Qarkut Korçë te Bashkia Korçë, dhe kalimin në pronësi të ndërtesës e të mjediseve administrative, nga Bashkia Korçë te Këshilli i Qarkut Korçë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1223, datë 3.9.2008, të këshillit të ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në pronësi Këshillit të Qarkut Korçë".
Pas shkëmbimit të ndërtesave respektive midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë bazuar në VKM Nr. 601 datë 31.08.2016, për rregullimin e situatës së krijuar faktike dhe ligjore nga ky shkëmbim, Këshilli i Qarkut Korçë me mirëkuptim ka rishikuar mundësinë për tu siguruar ambjente për ushtrimin e funksioneve të tyre edhe institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë dhe institucioneve të tjera.
Me kontratë huapërdorje Nr. 644 Prot. datë 17/07/2019 institucionit të Prefektit të Qarkut i është dhënë në përdorim kati i parë i godinës, pasuria nr. 2/708-N2, Vol. 43 Fq. 82 në ZK. 8564, me sipërfaqe 552.28 m² ndodhur në Lgj.7, Rruga "28 Nëntori" nr.1, Korçë.
Kati përdhe i godinës, pasuria nr. 2/708-N1, Vol. 43 Fq. 81 në ZK 8564, me sipërfaqe 652.88 m² është vendosur në dispozicion të institucioneve të tjera të sistemuara, si Zyra e Përmbarimit Shtetëror Korçë, Zyra e Statistikës Korçë dhe Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor,.
Në kushtet aktuale vetë Këshilli i Qarkut ushtron veprimtarinë në ambientet e ndërtesës që është në pronësi të Bashkisë Korçë, me Kontratë Huapërdorje prej datës 01.09.2019 me një afat 10-vjeçar. Me qëllim sistemimin dhe mundësinë e ndërhyrjes për mirëmbajtje tek godina ku ushtron aktualisht aktivitetin, Këshilli i Qarkut Korçë i është drejtuar me një kërkesë Bashkisë Korçë për kalimin në pronësi të pasurive të identifikuara si pasuritë me Nr.2/12 vol.27 faqe 167 me sipërfaqe

349,6 m² , Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168 me sipërfaqe 442 m², trualli nën ndërtesën nr.2/708-N1, identifikuar me pasurinë nr.2/10, vol.33, faqe 19, me sipërfaqe 652,88 m², në pronësi të Bashkisë Korçë.

Me VKB nr. 32 datë 29.02.2024 nga ana e Keshillit bashkiak Korçë është dhënë pëlqimi për kalimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë, pasuritë e identifikuara me Nr.2/12 vol.27 faqe 167 me sipërfaqe 349,6 m² , Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168 me sipërfaqe 442 m², trualli nën ndërtesën nr.2/708-N1, identifikuar me pasurinë nr.2/10, vol.33, faqe 19, me sipërfaqe 652,88 m².

Në këto kushte kërkojmë nga Këshilli i Qarkut dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të tij, të pasurive të identifikuara me Nr.2/12 vol.27 faqe 167 me sipërfaqe 349,6 m² , Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168 me sipërfaqe 442 m², trualli nën ndërtesën nr.2/708-N1, identifikuar me pasurinë nr.2/10, vol.33, faqe 19, me sipërfaqe 652,88 m².

**Koncept. : R. Latollari**
**Kësh. Juridik : Gj.Kristo**